



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Përkthim A-B

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 10 leksione / 40 seminare

Viti / Semestri : Viti III , semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë synon të aftësojë studentin në përkthimet e para nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj të një shkalle vështirësie të mesme, të cilat përmes përdorimit të fjalorëve dhe konsultave në auditor do të arrijë të tejkalojë vështirësitë fillestare në përpjekjen e tij për të sjellë në gjuhën e huaj materialet e dhëna.

Objektivat specifike lëndore:

1. Aftësi për të fituar koncepte bashkëkohore të përkthimit.
2. Aftësi për të trajtuar situata të ndryshme të vështira.
3. Njohuri mbi faktet përkthimore dhe sjelljen e përkthyesit.
4. Aftësi për të shprehur mendime të vështira nga ana gjuhësore.
5. Aftësi për të punuar në ekip dhe për të bashkëpunuar me persona të tjerë.

Rezultatet e pritshme:

1. Zbatojë parimet bazë të përkthimit nga shqipja në gjuhë të huaj në nivel mesatar vështirësie, duke përdorur me kompetencë fjalorët dhe burime të tjera ndihmëse.
2. Zgjidhë situata përkthimore problematike, duke treguar aftësi për të përballuar struktura komplekse dhe për të shprehur ide të ndërlikuara në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.
3. Reflektojë mbi procesin përkthimor, duke kuptuar sjelljen e përkthyesit dhe duke analizuar vendimmarrjen gjatë përkthimit në kontekste të ndryshme.
4. Bashkëpunojë në mënyrë efektive në punë në grup, duke kontribuar në mënyrë aktive në diskutime dhe vendimmarrje kolektive lidhur me zgjidhjet përkthimore.